

VALTER MEMISHA

**VËZHGIME GJUHËSORE NË VEPRËN E PETRO MARKOS RETË  
DHE GURËT (INTERVISTË ME VETVETEN)**

Për Petro Markon është shkruar dhe do të shkruhet përsëri. Mbi veprën e tij janë bërë studime e të tjera do të bëhen, të pjesshme a tërësore qofshin ato. Dhe për të gjithmonë do të ketë diçka të re për të thënë apo diçka të thënë ndryshe. Ky proces nuk do të ketë kufij hapësinorë apo kohorë. Dhe kjo e mundësuar, jo vetëm nga pozita e studiuesit, por, në radhë të parë, nga karakteri palimpsestor i veprës që ai na la trashëgim. Në këtë punim të shkurtër jemi ndalur në *disa vëzhgime gjuhësore* të “Retë e gurët (Intervistë me vetveten)”, një vepër që formalisht i përket prozës. Shkencërisht pranohet se veçoria e përgjithshme e prozës është formësimi i botës artistike me mjete gjuhësore që organizohen stilistikisht në mënyrë të atillë që të mos ndryshojë nga të folurit e zakonshëm. Kjo vepër, edhe pse shenjohe si *intervistë*, është një manual kujtimesh të shkruara në prozë, duke u gjendur, siç thotë Milivoj Sovar, “midis prozës artistike dhe shkencës”<sup>1</sup> dhe “... bashkojnë interesin historiko-shoqëror me formësimin artistik. Në to mund të theksohet nevoja që të shprehen edhe të përshkruhen si veprimtaria shoqërore, politike dhe shkencore e individëve, ashtu dhe meditimet e tyre ose ngjarjet ku marrin pjesë, gjithmonë në mënyra që i përkasin sferës artistike”<sup>2</sup>.

“Retë e gurët (Intervistë me vetveten)” është shkruar nëpër dy kohë nucionore, ndaj edhe është konceptuar në dy pjesë: *Petro Marko plaku interviston Petro Markon e ri* dhe *Petro Marko plaku interviston Petro Markon plak*. Lehtësisht mund të vërehet se nuk jemi para strukturës së një veprë homogjene, por para strukturimit të mbamendjeve ose siç thotë vetë autori i tyre, i hedhjes në letër i atyre që kanë rrjedhur nga “rubineti i detit të kujtesës”. Po, kështu shprehet, nga *rubineti i detit*. Kjo bëhet me vetëdije dhe jo për asociacion me detin Jon, që nuk iu nda shpirtit dhe zemrës së tij, në të përpjetat dhe theqafjet e jetës së trazuar, por për detin metaforik, për atë det, në të cilin, nga vendi ku i ra koka, derdhen rrëke, përrenj e lumenj ujërash, që me amën te retë çojnë tek ai ujë të kristaltë, por edhe gurë e shkëmbinj, pemë, shkurre e baltë. Dhe kjo shumësi ardhjesh që shpërfaqet në faqet e veprës si laryshi informacioni, ka kërkuar e gjetur regjistrat gjegjës për t’u formësuar

<sup>1</sup> M. Solar, *Hyrje në shkencën për letërsinë*, përshtati F. Dado, Tiranë, 2001, f. 153.

<sup>2</sup> Po aty, f. 166.

gjuhësisht, duke krijuar atë spektër shprehjeje që të magjeps, si të jetë prozë e mirëfilltë artistike.

Vertikaliteti i stilit të mbamendjeve, të strukturuar në formë interviste, më e pakta, do të kërkonte një horizontalitet gjuhësor, që duhet të ishte gati i sheshtë, madje dhe homogjen. Por në veprën “Retë e gurët (Intervistë me vetveten)” kemi thyerje e diversitet, kemi ndërthurjen e disa lloje tekstesh, të cilat nga ana e përmbajtjes mund të klasifikohen si *kronografi* (kohëpërshkrime e moshëpërshkrime për dikë), si *topografi* (vendpërshkrime) dhe si *prosopografi* (portretpërshkrime). Kjo trini, që degëzohet në nëntekste të shumta, ka përcaktuar edhe mjetet e shprehjes së tyre. Është e kuptueshme që në pamje të parë mbizotëron teksti dialogues, sepse vepra është konceptuar si një strukturim pyetje / përgjigje për kaleidoskopimin e jetës së autorit në një intervistë me vetveten (dikush tjetër, sidomos ndonjë nga studiuesit e rinj, mund të bëjë një përjasje me Autobiografinë e F. Nolit)<sup>3</sup>. Por, gjuhësisht, në vepër mbizotërojnë tekstet narrative, përshkruese dhe informativo-paraqitëse, të ndërhuara, si nga rrallëkush, me verbën e qëmtuar e të larë të shqipes. Gjithashtu, vepra si një e tërë, jep mesazhe të panumërta: mesazhe politike, ideologjike, filozofike, sociale, ekonomike, familjare, pedagogjike etj., të cilat sjellin formësimin e tyre edhe përmes teksteve të tjera si tekste a pasazhe tekstesh argumentuese<sup>4</sup>, letrarë-poetike<sup>5</sup>, madje edhe dialogueso-teatrore<sup>6</sup>.

Për të ilustruar, po japim nga një fragment të shkurtër për 2 lloje tekstesh, të shkëputura nga kjo vepër:

a. Tekst argumentues:

*Ai nxori këto konkluzione:*

*1. Zogu nuk kishte frikë nga komunistët. Përkundrazi, sipas tij, komunistët e përforconin regjimin e Zogut. Thoshte: “nuk është budalla Zogu që lejon të vijnë nga Moska agjentët e saj. Ai jo vetëm i lejon, por u jep edhe punë speciale, me rroga të majme. Lejon romanin “Nëna” jo tani që është qeveria e Mehdi beut, por që kohën e Musa Jukës. Lejon të shkruani vjersha*

<sup>3</sup> *Autobiografia* e F. Nolit është shkruar në vetën e tretë dhe jo në vetën e parë, në vetën e rrëfimitarit, edhe pse është autobiografi. Narracioni ndryshon vetën, por, gjithashtu, ndryshojnë të gjithë përbërësit gjuhësorë, sidomos ata që lidhen me progresionin tematik, me sintaksën, me asnjësimin e shprehësisë së stilit në vetërrëfim etj. *Shih* F. Noli, *Autobiografi*, në Vëllimin 6, Tiranë, 1996, f. 233-308.

<sup>4</sup> *Shih*, fjala vjen, f. 162, të veprës *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)*, Tiranë, 2000.

<sup>5</sup> Kemi me qindra fragmente e faqe të tëra kur mbamendjet mund të përfshihen stilistikisht në letërsi artistike. *Shih*, p.sh., faqet 248, 265 etj. të veprës *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)*, Tiranë, 2000.

<sup>6</sup> *Shih* për këtë, fjala vjen, po aty, faqet 162, 324 etj.

dhe shkrime revolucionare, si ti, që i kushtove një ligjërimë Leninit, me rastin e përvjetorit të vdekjes. I lejon, por jo pa qëllim; i thotë Musolinit: pa shiko se ç'agjentë na dërgon këtu Moska! Kemi nevojë për ndihma materiale, që t'i luftojmë. Dhe merr nga Roma miliona e i fut në xhep."

2. Sipas Brankos, gjer atëherë në Shqipëri nuk kishte asnjë marksist-leninist kompetent. Të gjithë ne e deshëm komunizmin pa e njohur se ç'ishte komunizmi.

3. Sipas tij, ne më shumë luanim rolin e disgregatorit dhe jo të unitetit të të gjitha forcave përparimtare. Thoshte: "Unë jam demokrat, idealist, dhe Tajari më lufton. Unë dua një Shqipëri demokratike, si atë të Nolit, si atë të Turqisë së Mustafa Qemalit, por Tajari dhe shokët e tij më quajnë "armik"! Pse? Unë, sipas mendimit tim, kërkoj një zhvillim të shoqërisë ku të kenë vend komunistët dhe gjithë patriotët e antifashistët. Nuk më pëlqejnë polemikat që shpien ujë të mulliri i përçarjes, ashtu si i pëlqen Zogut. Atij i pëlqen që ne të përçahemi dhe të mos bashkohemi kurrë."

b. Tekst letrar:

Atë mbrëmje, i mërzhitur në kulm, hipa në dritare dhe vështroja oborrin e burgut. Bosh. Vetëm një ushtar italian bënte rojë (se natën vinin në oborr roja italiane), shëtiste i menduar. Më pa dhe m'u afrua. Më foli:

- Pse je në burg? Ç'ke vjedhur?

- Nuk kam vjedhur gjë!

- Unë, - tha ushtari italian, - kam bërë pesë vjet burg në Napoli për vjedhje, dhe tani jam rojë këtu... - dhe qeshte.

I thashë se vuaja në burg, pasi isha kundër Musolinit.

c. Tekst dialogues:

Liloja: - Kam ardhur nga fshati. Dua një të mirë nga ju (dikush e përktente, se, siç dukej, motra fliste me ndonjë oficer italian).

Oficeri: - Nuk është e mundur të takoheni me të, se ende nuk është gjykuar!

Liloja: - Jo nuk kam ardhur ta takoj, po t'ju lutem juve që ta varni sa më parë, që të mbledhim mendjen, se s'kemi as këmbë, as zemër e as para që ta ndjekim në burgje dhe internime.

Leximi "me një frymë" i kujtimeve të Petro Markos, djalosh, të burrrëruar a të moshuar, ka të bëjë natyrshëm me shprehjen mjeshtrërore gjuhësore. Autori i tyre kalon lirshëm nga regjistrat shënjes në ata estetikë dhe lexuesi pas mbarimit të faqes së fundit, nuk mbyll një libër lodhës, drobitës, me ngjarje, njerëz, vende etj. të panumërta, që kërkojnë një kujtesë kompjuterike për t'i risjellë në mendje, por një libër gati si fiksjon (trillim, sajim) artistik, të ndërtuar me art edhe nga ana gjuhësore. Informacioni shumështrësor, shumëregjistrësh, vjen përmes një rrjedhe, gjuhësisht të

kristaltë, sepse vjen nga dora e një prej mjeshtëreve më të spikatur të prozës artistike.

“Retë e gurët (Intervistë me vetveten)” është një vepër që sendërtohet më shumë sesa një *metafiksion*. Kujtimet zakonisht, për nga koherenca, markohen nga një narracion progresiv sidomos në kohë, si dhe me fjalë në kuptimin e tyre parësor, të drejtpërdrejtë, jo të figurshëm. Por te Petro Marko ndodh ndryshe, edhe këtu, fjala informon, shpreh, ngulit në kujtesën e të tjerëve përmes kujtesës së autorit, duke u shndërruar shumë shpesh figurshëm. Është pjesa dërrmuese e librit e shenjuar artistikisht. Mjafton një pasazh i shkurtër i ndërtuar artistikisht përmes antitezave foljore apo emërore për të ilustruar këtë shndërrim: “Unë nuk kam mbajtur kurrë shënime, ku të shkruaja ç’kisha parë e ç’kisha dëgjuar, ç’kisha qarë e kënduar, ç’kisha thënë e ç’më kishin zënë veshët, prandaj këto që tani nisa t’i nxjerr nga pellgu i paanë i mbresave të jetës sime shumë, shumë të gjatë, po i nxjerr nga kujtesa që ende nuk më ka lënë. Nuk po shfletoj as dokumente, as shkresa, as shkrime, por i çel rrugë detit të pafund të mbushur për shtatëdhjetë vjet me radhë”<sup>7</sup>.

Intervistat kujtimore në dy kohë tregojnë se liria rebeluese, natyra e panënshtuar e të riut luftëtar e idealist, pasohet e ndërthuret me talentin rrëfimtar të jashtëzakonshëm të shkrimtarit të pjekur e me përvojë kurse ndërtimi gjuhësor i të dy pjesëve është kaq organik, sa duhet një punë e mirëparacaktuar për të gjetur ndryshorët që vetjakësojnë Petron Markon e Ri nga Petro Marku Plaku. Dhe përmes një narracioni paraqitës, por edhe argumentues njëkohësisht, përmes gërshetimit mjeshtëror të fjalëve të ligjërit të zakonshëm me ato të shndërruara metaforikisht, autori i kujtimeve pohon: “Edhe milingona ka jetën e vet. Çdo gjë e gjallë ka jetën e vet, lind, jeton vdes. Çdo njeri ka jetën e vet. Ka gëzimet dhe dhembjet e veta. Këto gëzime dhe këto dhembje kanë përmasat e horizonteve dhe të mjediseve ku ai lind, jeton dhe vdes. Stinët e moshës, stinët e pasioneve, ëndrrave, dëshirave përcaktojnë krijimin e kushteve të jetës me anën e armëve që përdor njeriu. Cilat janë armët që përdor njeriu për të jetuar? Puna! Puna është jeta! Puna! Krijimi është motori që vë në lëvizje këmbët e jetës, që hap shtigje të reja, burime të reja, kanune të reja që sjell përparimin. Anekset: intriga dhe frika, smira dhe dhuna, tradhtia dhe pabesia, poshtërimi dhe krimi... ngjyrat e zeza (në dëlirësinë e jetës, nën diellin e betejave për të jetuar) kanë qenë dhe do të jen kurdoherë turpi i jetës. Kontradiktat do të jetojnë bashkë me jetën, por duhet të pakësohen dhe të zhduken ato antagoniste dhe të ecet me joantagonistet. Jeta një herë jetohet!”<sup>8</sup>.

<sup>7</sup> Po aty, f. 12.

<sup>8</sup> Po aty, f. 12-13.

Stili rrëfimtar popullor pulsohet nga vlaga artistike e shkrimtarit, trashëgimia e të cilit gati i njeh të gjitha gjinitë e zhanret e letërsisë. Janë të shumta pjesët ku mitikja, legjenda, e jashtëzakonshmja jepet me pasion e ndjenjë dhe gjuhësisht më se e arrirë e thukshëm. Përsëri mjafton një pasazh si ky i mëposhtëm për ta vërtetuar këtë. Madje atij nuk mund t'i shtosh fjalë të tjera ose ta perifrazosh, sepse mund ta shpërftytyrosh e t'i ulësh vlerat që shpërfaq: *“Thonë se gurët e mëdhenj atje poshtë në Shënmëri janë burrat që janë kthyer dhe kanë vdekur në vend. Po të jesh trim zemërbardhë e po të shkosh andej natën, i dëgjon të dëftojnë historitë e tyre. Po të jesh frikacak e zemërlig, nuk i dëgjon dot. Kurse ata burra që kanë ikur dhe kanë vdekur në kurbet janë bërë re... vijnë qajnë dhe ikin. Dhe mbi spitharët më poshtë, afër bregut mblidhen lotët e tyre siç mblidhet uji i shiut...”*<sup>9</sup>.

Petro Marko, i kthjellët dhe në çastet më të errëta të jetës, kalon nga njëri stil në tjetrin, nga njëri regjistër gjuhësor në tjetrin, mjeshtërisht e artistikisht. Diku është lirik e diku epik, diku nostalgjik e diku dramatik, diku komik e diku tragjik. E gjithçka rrjedh në ndërtime sintaksore të admirueshme, ndaj mendoj se sintaksa në veprën “Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)” është rrafshi gjuhësor kryesor ku mund të ndalësh shikimin për të shpërfaqur këtë shumësi e plotëri vlerash. Ai shkruan, me një truk të bukur artistik, jo në fillim të veprës për të përuddhësuar kujtimet, por në fund të saj, se *“Megjithëse unë linda i krishterë, në një fshat shumë besimtar, nuk jam rrëfyer kurrë para priftit përpara se të kungohesha... Por tani dëshiroj të rrëfhem përpara historisë përpara se të vdes”*<sup>10</sup>.

Për të pohuar vlerat e ndërtimeve sintaksore, që dalin thuajse vetvetishëm të latuara prej dorës së tij, do të mjaftonte vetëm një thënie ku del në pah një sintaksë modelore, me të gjitha llojet e fjalive, të para qoftë nga lloji i kumtimit, qoftë nga ana strukturore: *“Dikush më zgjoi. Sa ishin? Shtatë veta! Po të tjerët? Eh, Vaterlo! Pamë poshtë! Greminë nga nuk kalonte as dhia e as djalli vetë! Ç'të bënim? Dikush pa aty në fund disa njerëz që lëviznin. Dukeshin si miza. Ushtarë apo civilë? Kush e dinte! Fashistë apo shokët tanë? Kush e dinte! Nga t'ia mbanim? Të ktheheshim nga erdhëm: vdekja! Të zbrisnim në atë greminë: vdekja! Vendosëm të zbrisnim. Zvarriteshim me thonj e me dhëmbë. Njëri ra, ra! Dhe ulërima e tij therëse u përpi nga oshtima e klithmës. Zbrisnim, zbrisnim. Dhe gjer në drekë zbritëm... gjashtë veta. As që kishim nge të shiheshim në sy. Vumë re se të tjerë zbrisnin nga jugu, të tjerë nga veriu. Ishin tanët! Ndoshta ata kishin mbetur nga batalioni dhe nga brigada.”*

<sup>9</sup> Po aty, faqja e pasme.

<sup>10</sup> Po aty, f. 552.

Po kështu në se zbresim në një nivel më të ulët të sintagantikës sintaksore, në atë të organizimit të gjymtyrëve në fjali, përsëri do të shihnim mjeshttrin dhe mjeshtërinë e të shkruarit. Në fjalinë e mëposhtme gjenden dhjetëra (23) gjymtyrë homogjene, që e bëjnë rrëfimin të segmentuar, por patetik, enumerik e shumë domethënës: “Ç’mbetet në kujtesë, ka kaluar nëpër shoshën e viteve, të shqetësimeve dhe të ëndrrave, të realitetit lakuriq dhe të gjurmëve të forta të emocioneve, të imazheve, vizioneve, peizazheve, duarve, syve, zemrave, zërave, kujave, këngëve, valleve, intrigave, pasioneve, shqetësimeve, dashurive, flirteve, gjuhëve, tingujve, shfaqjeve të përditshme në ekranin e pafund të jetës”<sup>11</sup>.

Tekstet që ndërtojnë ngrehinën ditar të P. Markos, përgjithësisht, ndërtohen përmes *parashtrimit*, duke informuar apo duke paraqitur, dhe përcaktohen nga rrëfyesi i kujtimeve përmes *konfirmimit* vetjak, përcaktohen nga ai që kohëpërshkrimet, moshëpërshkrimet, vendpërshkrimet, portretpërshkrimet etj., i sjell para nesh, në një kohë kur ato i përkasin kohës së shkuar nocionore. Kjo kushtëzon ardhjen gjuhësisht të gjithë informacionit përmes *kohës së kryer të thjeshtë*, krahas kohëve të tjera të së shkuarës (*e pakryer, e kryer, më se e kryer, e kryer e tejshkuar apo e ardhme e së shkuarës*), të cilat më shumë vijnë si mbështetje të kësaj kohe themelore. E kryera e thjeshtë ka rol të pazëvendësueshëm në kthimin e ditarëve, të kujtimeve etj. në art. R. Bart thekson se “*e kryera e thjeshtë, guri themeltar i tregimit, sinjalizon gjithnjë art; ajo bën pjesë në ritualin e letërsisë së bukur... Në saje të saj realiteti nuk është më as misterioz, as absurd; ai është i qartë, gati familjar, krijuesi e mban atë tërësisht në dorë në çdo moment, realiteti pëson shtypjen ingjenioze të lirisë së tij*”<sup>12</sup>. Dhe po ky autor pohon më tej se “*E kryera rrëfimtare... përbën një nga ato faktet e shumta formale të vendosura midis shkrimtarit dhe shoqërisë për justifikimin e njëjës dhe qetësinë e palës tjetër. E kryera e thjeshtë shenjzot një krijim; përkatësisht ajo sinjalizon dhe imponon*”<sup>13</sup>.

<sup>11</sup> Po aty, f. 11.

<sup>12</sup> R. Bart, *Aventura semiologjike*, përkthyer nga R. Ismajli, Prishtinë, 1987, f. 48.

<sup>13</sup> Po aty, f. 48. Gjithashtu po ky autor shprehet se “*Përmes së kryerës së thjeshtë folja hyn në mënyrë implicite në një varg shkakor, merr pjesë në një tërësi veprimesh solidare dhe të drejtura, funksionon si shenjë algjebrike e një intence; duke përmbajtur një ndërdymje midis kohësisë dhe shkakësisë, ajo shkakton veprim, përkatësisht e bën Rrëfimin të kuptueshëm... “dhe pikërisht e kryera e thjeshtë është njajo shenjë operatorike përmes së cilës rrëfyesi e shpie shpërthimin e realitetit në një folje të ngushtë dhe të pastër, pa dendësi, pa vëllim, pa shpalosje, i vetmi funksion i së cilës është të bashkojë më shpejtësinë më të madhe të mundshme një shkaka e një qëllim.” Shih më gjerë R. Bart, *Aventura semiologjike*, përkthyer nga R. Ismajli, Prishtinë, 1987, f. 47.*

Po japim vetëm një pasazh të shkurtër (4-5 rreshta) në të cilin gjejmë 7 folje në të kryerën e thjeshtë: “Dhe ne, të ndërgjegjshëm, për mundimet që do të hiqnim, e lamë Shkollën Tregtare, u ndamë me shokët dhe morëm rrugët e mundimit dhe jo të realizimit të ëndrrave tona që trillonimin aty, në atë vend të bukur, aty, në vatrën tonë ku jetuam shatë vjet, pa asnjë hall, pa asnjë privim. U ndamë me premtimin se do ta nderonim shkollën që na edukoi, do ta nderonim Vlorën që na nanurisi me shpirtin e saj patriotik”<sup>14</sup>.

I lexon faqe pas faqe “Retë e gurët (Intervistë me vetveten)”. Ligjërimi aty ngrihet e aty ulet, aty hovet e aty shtrohet, aty ironizon e aty larton, aty të drithëron e aty të zemëron, aty të mbush me dashuri e aty të bën të përçmosh, aty të bën të respektosh e aty të urresh. Dhe çdo ngjyrë e ngjyresë e tillë vjen me një gjuhë të kërkuar, jo vetëm më një sintaksë të mirëndërtuar, por edhe me fjalë të mirëqëmtuara. Dhe çdo gjë del e goditur.

Petro Marko ka zënë vend në letërsinë tonë e në kulturën tonë kombëtare, si pohuam disa herë, si mjeshtër i fjalës dhe i stilit. Po e rimarrim këtë tipar të krijimtarisë së tij për të theksuar se te vepra që kemi marrë në analizë, edhe ndonjëherë, kur duket sikur kalon në thjeshtligjërim, që logjikshëm nuk pranohet në krijimtarinë artistike, gjuha më shumë skalit situata e gdhend portrete sesa ngarkohet me rëndomtësi. Po japim një miniskenë e cila është shkëputur nga një ndodhi kur P. Markos, si zakonisht në monizëm, dikush i inskenon ngjarje që ta çonin (si e çuan) në burg. Autori i kujtimeve “Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)” shkruan se “Me të vërtetë u nxeha shumë, se në jetën time rrallë jam nxehur: Shoku “X”! ka dy lloj burrërie: një si imja dhe një si jotja. Ti, me burrërinë tënde, që e kam dhjerë, jetoje i lumtur në kohë të Zogut, kurse unë vuaja internimeve dhe burgjeve. Burrërinë tënde e kam dhjerë, se ka dy lloj burrërie: një si jotja e një si imja. Me burrërinë tënde jetoje bukur, si pasha, në kohën e Duçes. Atë burrërinë tënde e kam dhjerë. Kurse unë në atë kohën, me burrërinë time, torturohesha, burgosesha dhe internohesha. Edhe sot, me atë burrërinë tënde, që përsëri e dhjes, ti jeton si pasha në këtë pushtet që ti e urren...”<sup>15</sup>

Nuk po ndalemi më tej në vështrime të tjera gjuhësore, që do të ishin përimëtuese. Kjo kërkon kohë dhe një format tjetër studimi.

Në përfundim, pohojmë se vepra “Retë e gurët” (Intervistë me vetveten)”, e shkrimtarit P. Marko, e vështruar përmes teksteve të ndryshme, brenda një megateksti, ka ardhur te lexuesi asnjëherë apo te receptuesi i profilizuar me mbresa të pashlyeshme. Kjo ardhje lidhet me kujtimet e autorit (të cilat mbartin elemente të theksuara subjektive si proces përzgjedhës për ngjarje a personazhe, që edhe pse janë reale, janë të larguara në kohë), lidhet

<sup>14</sup> P. Marko, *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)*, Tiranë, 2000, f. 68.

<sup>15</sup> Po aty, f. 501.

me informacione me interes edhe për kulturën tonë kombëtare, edhe pse ato markohen jo rrallë nga përjetimet vetjake sentimentale të shkruarit të tyre. Dhe këtu, siç u ndalëm shkurtazi në disa pika, rrafshi gjuhësor për ardhjen e tyre në këtë vepër shumështrësore dhe me nivel artistik të lartë ka rol të pazëvendësueshëm.

## SUMMARY

### LINGUISTIC OBSERVATIONS IN THE WORK OF PETRO MARKO, *RETË DHE GURËT (INTERVISTË ME VETVETEN)*

This short writing retains in some linguistic surveys of Petro Marko's work, "Clouds and stones" (An interview with himself) - "Retë dhe gurët (Intervistë me vetveten)", a work which formally belongs to the prose. This work is a manual of memories, written in an artistic way.

The work has come to the reader with a lot of indelible impressions. This coming is connected with author's memories (which carry subjective underlined elements like a selective process on events and characters that, though real, are distanced in time), it is connected with interesting information about our national culture, though those often are marked of personal sentimental arguments of their clerk (creator).

Here, shortly as in some of them, linguistic plane on their coming in this polystrated work, with a high artistic level, has an irreplaceable role.

Verticality of the style of memories, structured in form of an interview, the least, would search a linguistic horizontality that had to be plain, even homogeneous. In the work we find breach and diversity, we find the correlation of some different texts, which, based on the content, can be classified like chorography, like topography and like prosopography. This trinity that is ramified in many subjects has also determined their means of expression. The interview has also conditioned the through coming. Nevertheless, in the work, prevail narrative, descriptive and informative text, construct perfectly with the help of dredged and washed work of Albanian language.

The work, as a unit, gives numberless messages: politic, ideological, philosophic, social, economic, family, pedagogic messages, etc, which are formed in texts of a dialogue way (all the material is structured like questions and answers), also in other texts that are texts and argued passages of texts, literary and poetically, even dialogued and theatrical.

The memories, usually by the coherence are marked from a progressive narration, especially in time, also with words in their first meaning,

direct and not figurative. But it doesn't happen the same in Petro Marko's work. "Clouds and stones (An interview with itself)" is a work that incarnates more than a metafiction. Reading page after page, we can see that the speech is supple. Everything comes in a selected language, with a syntax that is constructed well, with well dredged words. In some cases when seems that P. Marko passes in a simple speech, the language is more carving situations and refining portraits, than being charged with ordinaryities.

In the work, the word informs, expresses, inculcates in the memory of others through the author's memory, being transformed very often figuratively.

Petro Marko artistically passes from one style to another, from one linguistic register to another. Somewhere he is lyric and somewhere epic; somewhere is nostalgic and somewhere tragic. Everything derived in admirable syntactic constructions, that's why I think that the syntax in the work "An interview with himself" is the main linguistic plain where everybody can stop his view to surface this entireness of values. Coming also down to the level of the organization of sentence parties, we see again the master and his skill of writing.

The kind of this work conditions, linguistically the coming of all information through the aorist, in parallel other tenses of the past (imperfect, present perfect, past perfect or future in the past) that are coming more as a support of this fundamental tense. The aorist has an irreplaceable role in transforming of diaries, memories, etc, in art. And Petro Marko has done this as nobody else in our cultural inheritance. As a conclusion this work of Petro Marko pushes to other linguistic study undertaking fuller and exhaustible.

